

# OBJEKTIVI jonë është forcimi i miqësisë

nga Musa MARJANLI,  
Kryeredaktor

Të nderuar lexues, mirë së të vini në faqet e revistës IRS-Trashëgimia Shprehim gëzimin e sigurt për takimin tonë të parë. Kohët e fundit vërehet një intensifikim i dukshëm i lidhjeve mes Shqipërisë dhe Azerbajxhanit, veçanërisht në fushën politike dhe ekonomike, dhe për këtë arsye, lindi nevoja e një botimi të këtij lloji, qëllimi i të cilit është të informojë sa më shumë lexuesin shqiptar për Azerbajxhanin, për të kaluarën dhe të tashmen e tij, kulturën dhe natyrën. Shpresojmë që ky botim do të ndihmojë në afrimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të miqësisë mes dy popujve, të cilët ndajnë lidhje të hershme historike dhe kulturore.

Është simbolike që botimi i numrit të parë të revistës sonë përkon me 30-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike mes dy vendeve tona. Këtij përvjetori të rëndësishëm i kushtohet një artikull i ambasadorit të Azerbajxhanit në Shqipëri z Anar Huseynov. Numri përmban gjithashtu materiale informative - një pasqyrë të shkurtër të historisë së Azerbajxhanit dhe një artikull për burrin e e shquar të shtetit Heydar Aliyev, ditëlindja e 100-të e të cilit festohet këtë vit. Interes të veçantë për lexuesin do jetë artikulli kushtuar bashkëpunimit Azerbajxhano-Shqiptar në industrinë e gazit.

Adhuresit e historisë do të jenë të interesuar për artikullin kushtuar çështjeve të diskutueshme të historisë së trashëgimisë së krishterë të Karabakut - rajoni historik i Azerbajxhanit, shumica e të cilit u bë objekt i pretendimeve territoriale të Armenisë dhe arenë e konfliktit ushtarak. Megjithëse konflikti armeno-azerbajxhanas ka përfunduar kryesisht si rezultat i Luftës Patriotike të vitit 2020, tensionet në Karabak dhe rreth tij vazhdojnë. Një nga pasojat e konfliktit dhe në të njëjtën kohë një tregues i situatës aktuale janë fushat e gjera të minuara në territoret e Azerbajxhanit të çliruara nga pushtimi, të cilat shërbejnë si burim rreziku për jetën e njerëzve dhe një pengesë serioze për procesin e restaurimit. Një artikull nga kreu i Agjencisë së Veprimit ndaj Minave të Republikës së Azerbajxhanit i kushtohet këtij problemi.

Në përfundim, shpreh dëshirën që komunikimi ynë, të dashur lexues, të jetë interesant për ju dhe të shërbejë, sado pak, si një kontribut për zhvillimin e miqësisë mes popujve të vendeve tona. Na ndiqni!